

## PËLLUMB XHUFI

### PËRKIME SHQIPTARO-MALAZEZE NË MESJETË

Milan Shufflay duket se ka dhënë thelbin e lidhjeve mes shqiptarëve e malazezëve në Mesjetë, kur pohonte se “Zeta dhe Shqipëria e veriut përbënin një fytyrë biologjike të veçantë: ishin të lidhura me të njëjtën tokë plastike, me të njëjtin gjak ilir e me të njëjtat peripeci historike”<sup>1</sup>. Në fakt, e gjithë kjo trevë e Ballkanit Perëndimor e ka përcjellur në të njëjtën mënyrë momentin kryesor të ndryshimeve të mëdha etnike e kulturore në Ballkan, atë të dyndjeve e të kolonizimit sllav. Historianë e linguistë të shumtë kanë arritur në konkluzionin se, në Malin e Zi të sotëm dhe akoma më në jug, në Shqipëri, kapërcimi nga antikiteti në Mesjetë nuk u karakterizua nga përmbysje etnike, pasi me përjashtim të infiltrimeve periferike sllave, aty masa dërrmuese e popullsisë mbeti e përfaqësuar nga banorët e lashtë, në radhë të parë ilirë<sup>2</sup>. Substrati i vjetër ilir mbeti një

<sup>1</sup> Milan Šufflay, *Srbi i Arbanasi*, Beograd: 1925, f. 52; Z. Vinski, “Autochtone Kulturelemente zur Zeit der slavischen Landnahme des Balkanraums”, në: *Simpozijum “Predslavenski etnički elementi na Balkanu u etnogenezi južnih Slovena”*, Mostar 1968; Centar za balkanološka ispitivanja, knj. 4, ANUBH pos. izd. knj. 12, Sarajevo: 1969, f. 177-178. Për mbijetesë të madhe të elementit të lashtë etnik, shqiptar e vllah, mes kolonëve të rinj sllavë, flet edhe Constantin Jireček, *Geschichte der Serben*, Gotha: 1911 (përkth. shqip: *Histori e serbëve*, Tiranë: “Botime 55”, 2010, f. 145).

<sup>2</sup> Ndër burimet vendase, përmendim dy letra të papës Gregori I, të vitit 591 e 593, ku bëhet fjalë për pushtimin e Lezhës e të kështjellave të tjera të Ilirikut nga barbarët (...*episcopos, quos e propriis locis hostilitatis furor expulerat*). Por në të njëjtat letra shprehej besimi se ky pushtim do të ishte i shkurtër, siç rezultoi në të vërtetë. Shih: *Monumenta Germaniae Historica*, Epistolae, vëll. I, Berlin: 1891, f. 69, 132. Shih gjithashtu: C. Jireček, *Geschichte...* Këtu citohet sipas përkthimit shqip, f. 145; Charles Diehl, “La civilisation balkanique à l’époque byzantine”, në: *Revue Internationale des Etudes Balkaniques*, 2<sup>e</sup> année, tom 3-4, Beograd: 1936, f. 377; Sima Ćirković, “Les Albanais dans les sources historiques des Slaves du Sud”, në: *Les Illyriens et les Albanais. Academie serbe des sciences et des arts. Colloques scientifiques*, vol. XXXIX. Classe des sciences historiques, vol. 10. Serie de conferences tenues du 21 mai au 4 juin 1986, réd. Milutin Garašanin, Béograd: 1988, f. 342-343; Peter Charanis, “Observations on the History of Greece during

nga përcaktuesit e marrëdhënieve historike shqiptaro-malazeze edhe në shekujt e parë të Mesjetës. Arkeologët, nga ana e tyre, kanë vënë re një vazhdimësi (kontinuitet) kulturash në viset e Shqipërisë së Veriut e të Malit të Zi të sotëm (Dioklea, Zeta) edhe pas zbritjes dhe kolonizimit sllav, që këtu nuk la gjurmët që la në viset më në Veri<sup>3</sup>. Për rrjedhojë, tashmë janë lëkundur seriozisht tezat e dikurshme mbi etnogjenezën e kësaj pjese të Ballkanit Perëndimor, të formuluar dikur nga një perspektivë serbocentrike<sup>4</sup>. Për një etnogjenezë “serbe” të popullsisë të Dioklesë së vjetër kishin folur emra të njohur të shkencës serbe e joserbe, si P. Ivić, P. Vlahović, Dj. Janković, R. Novaković, D. Obolensky, H-J. Härtel, V. Popović<sup>5</sup>, për të mos folur për autorë më të vjetër, Cvijić,

---

the early Middle Age”, në: *Balkan Studies*, 11 (1970) f. 23, shën. 78: “Për mua nuk ka asfarë dyshimi se shqiptarët ishin autoktonë në Gadishullin Ballkanik, që i mbijetuan invazionit sllav”.

<sup>3</sup> Arthur J. Evans, *Ancient Illyria. An archaeological Exploration*, London-New York (I. B. Tauris & Co Ltd) 2006, f. 35-37; P. Mijović, “Problemi isledovanja slavjanskih gorodov v Crnogorii”, në: *Raports du III<sup>e</sup> Congrès International d’Archéologie Slave*, vëll. 2, Bratislava: 1980, f. 274; Z. Vinski, “Autochtone Kulturelemente zur Zeit der ...”, f. 189, 192-193.

<sup>4</sup> Š. Kulišić, *O etnogenezi Crnogoraca*, Titograd: 1980, f. 11.

<sup>5</sup> Mbi autorët serbë, si P. Ivić, P. Vlahović, Dj. Janković e R. Novaković, që mbrojnë karakterin serb të popullsisë së Dioklesë, duke shtrembëruar edhe vetë pohimet e Porfyrogjenetit, shih kritikën e B. Ferjančić, të cilin do e citojmë më poshtë. Në të njëjtin pozicion si autorët e mësipërm duket se qëndrojnë edhe: Dimitri Obolensky, *Il Commonwealth bizantino*, Roma-Bari (Laterza): 1974, f. 142, 314; H-J. Härtel, në: F. G. Maier (Ed.), *L’Impero Bizantino*. Storia Universale Feltrinelli 13. Milano, 1974, f. 183-184; Vladislav Popović, “Byzantins, Slaves et Autochtones dans les provinces de Prévalitane et Nouvelle Épire”, në: *Villes et Peuplement dans l’Illyricum protobyzantin*. Collection de l’École Française de Rome 77, Romë: 1984, f. 211; P. G. Papademetriou, “Thesmikes scheseis kai stadia ensomatoses ton slavikon plethysmon ste byzantine autokratoria kata to dheutero miso tou 7<sup>ou</sup> aiona”, në: *Byzantina*, tom. 24, Thessalonike: 2004, f. 167-218. Për kritikën ndaj këtij leximi “serbocentrik” të Porfyrogjenetit, shih B. Ferjančić, “Dolozak hrvata i srba na balkansko poluostrovo. Osvrt na nova tumačenja”, në: *Zbornik Radova Vizantoloskog Instituta*, 35 (1996), f. 139. Në të kundërtën, leximit korrekt të Porfyrogjenetit i qëndrojnë, veç Ferjančić, edhe: J. Ferluga, “Das byzantinische Reich und die südslavische Staaten von der Mitte des 9. Jh. zur Mitte des 10. Jh.”, në: *Byzantium on the Balkans*, ed. Adolf M. Hakkert, Amsterdam: 1976, f. 303-305; M. Eggers, “Das De administrando Imperio des Kaisers Konstantinos VII. Porphyrogenetos und die historisch-politische Situation

Čorović, Erdeljanović<sup>6</sup>. Edhe për R. L. Veselinović, popullsia sllave e Malit të Zi edhe në shekujt e vonë (XVI-XVII) nuk mund të ishte tjetër veçse serbe<sup>7</sup>. Ndërkohë, autori grek, P. G. Papademetriou, arrin deri aty sa ta përfshijë Dioklenë (Zetën) në “vatrën historike të Serbëve”<sup>8</sup>.

Por, që nga C. Jireček<sup>9</sup> e deri së fundi bizantinisti i njohur serb B. Ferjančić<sup>10</sup>, kanë treguar tashmë se qëndrimi i mësipërm, përveç paragjytimeve me sfond nacionalist, rrjedh kryesisht nga një interpretim i gabuar i njoftimeve që jep në shek. X, historiani-perandor Konstantin Porfirogjenetos. Në fakt, ky nuk e përfshin Dioklenë në kuadrin e territoreve, ku Perandori Herakël (610-641) lejoi vendosjen e popullsisë sllave, e aq më pak atyre serbe. Sipas Porfirogjenetos, Dalmacia, deri në Grykën e Kotorrit (Dekaterion) “u zu prej popullsisë sllave”, ndërsa Dioklea, vazhdoi të qëndrojë në orbitën bizantine, tashmë në fqinjësi me vendet sllave të Serbisë, në lindje, e të zaklumëve, tërbunëve e

---

Südosteuropas im 9. und 10. Jahrhundert”, në: *Ostkirchliche Studien*, 56 (2007), f. 40-41; O. Kronsteiner, “Gab es unter den Alpenlawen eine kroatische ethnische Gruppe?”, në: *Wiener Slavistisches Jahrbuch*, 24 (1978), f. 137-157; M. Tadin, “Les Arbanitai des chroniques byzantines (XI<sup>e</sup>-XII<sup>e</sup> s.)”, në: *Actes du XV<sup>e</sup> Congrès International d’Études Byzantines*. Athènes, septembre 1976, vëll. IV (Histoire), Athènes, 1980, f. 327-330; Pëllumb Xhufi, në: *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 208.

<sup>6</sup> Š. Kulišić, *O etnogenezi...*, f. 11 e vijim.

<sup>7</sup> R. L. Veselinović, “Die “Albaner” und “Klimenten” in den österreichischen Quellen zu Ende des 17. Jahrhunderts. Historisch-geographische und ethnographische Abhandlung”, në: *Mitteilungen des Österreichischen Staatsarchivs*, 13. Band, Wien (Ferdinand Berger) 1960.

<sup>8</sup> P. G. Papademetriou, “Thesmikes scheseis ...”, f. 173.

<sup>9</sup> C. Jireček, *Geschichte...* (sipas përkth. shqip: *Historia e Serbëve...*, f. 150-151). Ky autor, madje, sheh një përdorim konfuz të etnikonit “serb” nga ana e Porfirogjenetit, dhe konkludon se kolonët sllavë të Dalmacisë së jugut nuk i përkisnin grupit serb: zakulmitët e travunitët ranë më vonë në varësi të serbëve të mirëfilltë me anë martesash dinastike. *Po aty*, f. 148-151.

<sup>10</sup> B. Ferjančić, “Dolozak orvata...”, f. 139. Në të kundërtën, leximit korrekt të Porfirogjenetit i qëndrojnë, veç Ferjančić, edhe: J. Ferluga, “Das byzantinische Reich...”, f. 303-305; M. Eggers, “Das De administrando Imperio des Kaisers...”, f. 40-41; O. Kronsteiner, “Gab es unter den Alpenlawen eine kroatische ethnische Gruppe?” në: *Wiener Slavistisches Jahrbuch*, 24 (1978), f. 137-157; M. Tadin, “Les Arbanitai des chroniques...”, f. 327-330.

kanalitëve, në Veri<sup>11</sup>. Kjo dinamikë e ndryshme në kohën e përmbysjeve të mëdha etnike e kulturore, qëndron në themel të identitetit të fortë që Dioklea arriti të krijojë qysh në Mesjetën e Hershme. Edhe pse, në gjendjen e sotme burimore, askush nuk është në gjendje të bëjë ndonjë vlerësim taksativ e përjashtimor lidhur me raportet etnike në këtë anë të Ballkanit, është mjaftimisht e provuar se këtu nuk pati një vërshim e më tej një kolonizim sllav, si në trevat më në veri e në lindje. Përkundër, është dëshmuar që në shek. VI-VII, në Diokle (Prevalitanë) e në brezin bregdetar të Shqipërisë së sotme, u vu re një rritje e elementit autokton me të ardhur të rinj nga viset e tjera ilirike të zëna tashmë nga sllavët<sup>12</sup>. Sipas Arthur J. Evans, nga analizat antropometrike mbi skelete të gjetura edhe në veri të Malit të Zi, në vendin e njohur përndryshe si i kanalitëve sllavë, dhe që i përkasin shek. XIII-XIV, rezulton se ata nuk i përkasin elementit sllav, ndërkohë që paraqesin ngjashmëri të madhe me elementin iliro-shqiptar<sup>13</sup>.

Krishterimi ishte në këto anë të Ballkanit Perëndimor një tjetër element kontinuiteti<sup>14</sup>. Ai zë fill këtu që në kohët e apostujve<sup>15</sup>. Në shek. VI, Kosmas i rendiste ilirët mes popujve të krishterë<sup>16</sup>. Që në shek. IV-VI, ashtu si në Dalmaci, në këtë trevë vihet re një përhapje e gjerë e

<sup>11</sup> Const. Porphyrogenneti, *De administrando imperio*, bot. G. Moravscik, Budapest: 1949, f. 139, 152-153.

<sup>12</sup> J. Ferluga, "Drač i negova oblast od VII do pocetka XIII veka", në: *Gllas*, 343, knj. 5 (1986), f. 68-69; B. Grafenauer, "Proces naseļjavanja slovena na zapadni Balkan i u istočne Alpe", në: *Simpozijum*, Sarajevo: 1969, f. 48 e vj., cituar sipas: B. Ferjančić, "Invasions et installation des Slaves dans les Balkans", në: *Villes et Peuplement dans l'Illyricum protobyzantin*. Collection de l'École française de Rome 77. Rome: 1984, f. 103; Aleksandër Meksi, "Të dhëna mbi historinë e hershme mesjetare shqiptare", në: *Iliria*, Tiranë: 1989, nr. 1, f. 117.

<sup>13</sup> Arthur J. Evans, *Antiquarian researches in Illyricum*, parts I-II, Westminster: 1883, f. 33-35.

<sup>14</sup> S. Čirković, "Les Albanais dans les sources historiques...", f. 345.

<sup>15</sup> J. Zeiller, "L'expansion du christianisme dans la péninsule des Balkans", në: *Revue Internationale des Études Balkaniques*, I année, tome 1-2, Beograd: 1935, f. 414.

<sup>16</sup> Jacques-Paul Migne, *Patrologia Graeca* (më tej: *PG*), 88, f. 169; K. Dieterich, *Byzantinische Quellen zur Länder-und Völkerkunde*, vëll. II, Leipzig: 1912, f. 18-19.

emrave të shenjtorëve të krishterë<sup>17</sup>. Për t'u shënuar për sa i përket ngushtësisht Dioklesë, është përhapja e kultit të martirëve të parë të krishterimit, Shën Baku e Shën Sergji, qendër e të cilit u bë manastiri i njohur benediktin në derdhjen e lumit Buna<sup>18</sup>. Njëlloj i përhapur ishte edhe kulti i Shën Gjergjit, Shën Mihalit, Shën Kollit. Krejt specifik për arealin shqiptaro-malazez ishte kulti i Shën Gjon Vladimirit, që gjeti përhapje deri në Durrësin e Elbasanin e largët. Deri në kohët moderne, për nder të këtij shenjtori organizohej në Krajë, ditën e Rëshajave, procesioni i “kryqit të Krajës”.<sup>19</sup> Pjesëmarrja në të si e besimtarëve ortodoksë, ashtu edhe e atyre katolikë e myslimanë, flet për pikëtakime të hershme historike e etno-kulturore të banorëve të atyre trevave<sup>20</sup>.

Në pikëpamje ekonomike, sociale e kulturore, ngjashmëria mbresëlënëse midis statuteve të Budvës, Tivarit, Ulqinit dhe atyre të Shkodrës flet për rrethana të ngjashme gjithashtu në qytetet e Malit të Zi të sotëm e të Shqipërisë së veriut<sup>21</sup>. Mjafton të kujtojmë që institucione të ndryshme,

<sup>17</sup> Milan Šufflay, “Die Kirchengestände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Damme”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*, München und Leipzig: 1916, f. 256; Constantin Jireček, “Das christliche Element in der Topographie der Balkanländer”, në: *Wiener Sitzungsberichte*, 136, f. 9 e vijim.

<sup>18</sup> Constantin Jireček, *Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters*, 2. Teil, Wien: 1903, f. 57-58; Po ai, *Geschichte der Serben* (përkth. shqip), f. 212.

<sup>19</sup> C. Jireček, *Geschichte der Serben ...*, f. 240-241 (përkth. shqip); M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi*, f. 99.

<sup>20</sup> I përhapur ishte, sidomos në qytete, edhe kulti i Shën Stefanit, që gjasisht lidhet me rënien e tyre nën sundimin serb, në shek. XII. Statutet e Shkodrës dhe ato të Tivarit na i tregojnë ditën e Shën Stefanin si një pikë referimi të jetës ekonomike e sociale të këtyre qyteteve<sup>20</sup>. Në Shkodër, katedralja e qytetit mbante emrin e Shën Stefanit. Aty, çdo vit, në pranë të besimtarëve të shumtë, “ndodhnin disa mbrekulli të Shën Stefanit” (*ecclesia Scutarensis, que in honorem beati Stephani prothomartiris gloriosi dicitur, et in qua ob honorem ipsius prothomartiri nonnulla miracula Christi fidelibus ad eam confluentibus altissimus operatur*), në: A. Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia*, t. I (1198-1549), Romae, 1863, nr. 286.

<sup>21</sup> “Statuto di Budua”, në: S. Novaković, *Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka*, 5 knjiga, Beograd, 1912, f. 44-75; S. Marković, “Lo statuto di Antivari (sec. XIV)”, në: *Studi Veneziani*, n.s., 54 (2007), f. 239-278; A. Pertusi, “Per la storia di Dulcigno nei secoli XIV-XV e dei suoi Statuti cittadini”, në: *Studi*

përfshirë edhe ai i hakmarrjes (*vendetta, urazba*) trajtohen në të njëjtat terma, si në Statutet e Budvës ashtu edhe në ato të Shkodrës<sup>22</sup>. Në arealin shqiptaro-malazez, fenomeni i hakmarrjes ishte padyshim edhe një tregues i lidhjes së qyteteve me hinterlandin e tyre malësor, ku edhe e kishte origjinën ky fenomen. Sigurisht, në malësi, hakmarrja ekzistonte në formën e vet më ekstreme, atë të gjakmarrjes, si formë e përhapur për zgjidhjen e konflikteve dhe armiqësive. Asaj nuk mund t'i shpëtonte askush, as dinjitarët e vendit. Kështu, në 1414, princi Balsha III duhej të ruhej si çdo i krishterë i zakonshëm, nga hakmarrja e fisit të Hotëve, me të cilët “kishte rënë në gjak” (*quia manus posuit in sanguine eorum*)<sup>23</sup>. Interesante është, që në prizmin e kësaj norme të vjetër kanunore shqiptare, i sheh marrëdhëniet armiqësore të shqiptarëve të Veriut me Nemanjidët serbë në 1331, edhe arqipeshkvi frëng i Tivarit, Guljelm Adami<sup>24</sup>.

Nga fundi i shek. XI, sipas Kekaumenos, vendet e Dioklesë filluan të njihen me emrin “Zenta” (Genta, Zeta)<sup>25</sup>. Atë kohë, Zeta shtrihej nga

---

*Veneziani*, 15 (1973), f. 213-271; Oliver J. Schmitt, “Un monumento dell’Albania medievale”, në: L. Nadin (ed.), *Statuti di Scutari*, Roma (Viella): 2002, f. 30-31.

<sup>22</sup> “Statuto di Budua”, në: S. Novaković, *Zakonski spomenici*, f. 66; L. Nadin, *Statuti di Scutari*, f. 156.

<sup>23</sup> Nicolae Jorga, *Notes et extraits pour servir à l’histoire des Croisades au XV<sup>e</sup> siècle*, vëll. I, Paris, 1896, f. 254; G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balseidi*, (bot. shqip. 2009), f. 332-333. “Në gjak” ishte Balsha III, në 1413, edhe me Shestanët e malësisë së Tivarit: në fakt, ai kishte urdhëruar t’u pritej një këmbë e një dorë dy vëllezërve Shestanë, pasi këta u lidhën me Venedikun (N. Jorga, *Notes et extraits*, I, 212-213), shenjë kjo, që edhe marrëdhëniet “politike” në këtë mjedis ishin prekur nga rregulli i gjakmarrjes, siç e konfirmon në 1332 edhe Guljelmi i Adës, i cili i sheh nën prizmin e “gjakut” edhe marrëdhëniet e shqiptarëve me pushtuesit e tyre serbë: “*ipsi omnes et ipsorum singuli in predictorum Sclavorum sanguine manus suas crederent consecrare*”, shih: Brocardus, “*Directorium ad passagium faciendum*”, në: *Recueil des historiens des Croisades. Documents Armeniens*. Tome II, Paris, 1906, f. 484.

<sup>24</sup> “*Et quia dicti, tam Latini quam Albanenses, sub jugo importabili et durissima servitute illis odiosi et abhominandi Sclavorum dominii sunt oppressi...ipsi omnes et ipsorum singuli in predictorum Sclavorum sanguine manus suas crederent consecrare*”. Shih: Brocardus, “*Directorium ad passagium faciendum...*”, f. 484.

<sup>25</sup> Kekaumenos, *Strategicon*, ed. B. Wassiliewsky-V. Jernstedt, St. Petersburg: 1896, f. 27: “εις τὰ κάστρα Δαλματίας εἰς τὴν Ζένταν”.

Gjiri i Kotorrit e deri në derdhjen e Bunës, ku ndodhej manastiri i Shën Sergjit e Bakut dhe ku çdo vit organizohej një panair i madh krahinor<sup>26</sup>. Ishte vatra e një trekëndëshi të madh Kotorr-Ulqin-Prizren, ku sipas Shuflajt, u realizua në Mesjetë simbioza etnike shqiptaro-sllave<sup>27</sup>. Në këto treva, në shek. XIV, banonin “të krishterë që flisnin gjuhë të ndryshme”<sup>28</sup>. Të dhëna të ndryshme, qysh nga Porfyrogjeneti në shek. X, Guljelm Adami në shek. XIV e deri në shek. XV flasin për mbeturina të popullsisve të romanizuara në disa nga qytetet e Zetës së vjetër<sup>29</sup>. Por, nuk mund të mos vëmë në dukje se Marin Barleti, në rastin e banorëve “romanë” të Drishtit, na thotë se ata nuk ishin në fakt të tillë, por hiqeshin si romanë “për t’i shtuar lavdinë vetes dhe qytetit të tyre”<sup>30</sup>. Fenomeni ndeshet, në një mënyrë të ngjashme, edhe në qytetin e Durrësit, ku kishte shumë qytetarë që për arsye të ndryshme, përpiqeshin të shtiheshin si “Venecianë” (*qui pro Veneto expeditantur*), pa qenë absolutisht të tillë<sup>31</sup>. Ne jemi rrekur të provojmë, se tek shtresa të caktuara (tregtare, intelektuale) vihet re prirja për t’u identifikuar si italo-romanë, duke adoptuar për këtë qëllim edhe emra të fondit latin apo edhe italian, shpesh herë duke shndërruar në të tillë emrat tipikë shqiptarë, që mbanin më

<sup>26</sup> “*a panaiuro Sancti Sergii de Zenta*”, në: Ludvig von Thallóczy - Constantin Jireček - Milan Šufflay, *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia (Acta Albaniae)* (më tej: AD), vëll. II, Wien, 1918, nr. 344, f. 80.

<sup>27</sup> Milan Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*, Wien und Leipzig: 1924 (bot. shqip: Tiranë, 2009, f. 75); M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi*, Beograd: 1925, f. 75; S. Ćirković, *Les Albanais dans les sources des Slaves du Sud*, f. 351.

<sup>28</sup> “*que a fidelibus christianis diversarum linguarum inhabitantur*”. Bëhet fjalë për krahinat e Kunavljës, Trivunës, Drazavica, Ressian, Budua, Lastua, Prizren, Novobërda, Trepça, Breschova, Rudnich.

<sup>29</sup> Const. Porphyrogenneti, *De administrando imperio*, f. 153; Brocardus, “*Directorium ad passagium faciendum*”, f. 483. Një akt i Senatit të Venedikut i 19 nëntorit 1404, që flet për Shkodrën, Lezhën e “vendet e tjera” të atyre anëve që kishin kaluar nën sundimin e Venedikut, bën fjalë edhe për “*quolibet locorum tam Albanensium quam Latinorum*”, shih: AD II, f. 756.

<sup>30</sup> Marin Barleti, *De vita, moribus ac rebus Georgii Castrioti, clarissimi Epirotarum principis*, Argentorati 1537 (bot. shqip, Tiranë, 1967), f. 159.

<sup>31</sup> AD II 509; Pëllumb Xhufi, “La population des villes cotières du XII<sup>e</sup> au XV<sup>e</sup> siècle”, në: *Studia Albanica*, Tiranë: 1982, nr. 2, f. 156. Lidhur me fenomenin në përgjithësi, shih: D. Jacoby, “Citoyens, sujets et protégés de Venise et de Gênes”, në: *Byzantinische Forschungen*, 5 (1977), f. 159, 166; Chr. Malteziou, “Paratereseis ston thesmo tes Ventikes ypokootetas”, në: *Symmeikta*, 4 (1981), f. 2-4.

parë<sup>32</sup>. Gjithsesi, problemi i “popullsive latine” të mbijetuara në shekujt e mesjetës së vonë, duket se futet në hullitë e realitetin nga Mauro Orbini (1601), i cili thotë se kolonitë romake në qytetet e Dalmacisë, që përdornin gjuhën latine, u shuan që kur aty erdhën sllavët, në fillim të shek. VII<sup>33</sup>. Në këtë kuptim, nëse mbeturina të kësaj popullsie romane mbetën edhe më tej në viset më në jug të Dalmacisë, d.m.th. në bregdetin në vazhdim të Zetës, kjo do të ishte një provë tjetër se sllavët nuk arritën të shtrihen tej Grykës së Kotorrit dhe këtu vazhduan të ekzistojnë elementët etnike të kahershëm, përfshirë edhe grupe të popullsive romane. Në çdo rast, në shekujt e mesjetës së vonë, bazën e popullsisë së Dioklesë (Zetës), e përbënin padyshim shqiptarët e sllavët<sup>34</sup>. Për sa i përket shqiptarëve, këta rezultojnë të shumtë në qytete. Ulqini në vitin 1553 dëshkohet si i banuar tërësisht nga shqiptarët<sup>35</sup>. Më tej, në 1610 Marin Bici i relatonte Papës Pali V, Ulqini kishte atë kohë 80 shtëpi, të banuara thuajse të gjitha nga të krishterë katolikë” ndërkohë që banorët “nuk flisnin gjuhë tjetër veç shqipes dhe turqishtes”<sup>36</sup>. Shkodra dëshkohet aq shqiptare në fund të shek. XIV, saqë qeveritari venedikas i qytetit detyrohej të mbante përkthyes për të komunikuar me vendasit, kurse Tivari në shek. XVI paraqitej gjysëm shqiptar e gjysëm sllav<sup>37</sup>.

Por popullsia shqiptare ishte masive edhe jashtë qyteteve, në hinterlandin e tyre. Brokardi, në 1332, thotë se popullsia jashtë mureve të qyteteve të dioqezës së Tivarit, me vetë Tivarin, Kotorrin, Ulqinin, Shasin, Shkodrën e Drishtin, ishte shqiptare (*populus vero earum sunt Albanenses in tota ipsarum diocesi extra muros*).<sup>38</sup> Me gjithë ndryshimet e ndodhura në kohë, deri dhe Kongresi i Berlinit, në 1878, njihte se treva

<sup>32</sup> P. Xhufi, “La population des villes cotières du XII<sup>e</sup> au XV<sup>e</sup> siècle...”, f. 154.

<sup>33</sup> “Egli è ben vero, che in alcune città maritime della Dalmatia erano colonie de’Romani, le quali parlauano nella lingua Latina. Ma queste quasi quasi tutte s’estinsero, quando quei luoghi furono occupati da gli Slavi”, shih: M. Orbini, *Il Regno de gli Slavi*, Pesaro: 1601, f. 173.

<sup>34</sup> M. Šufflay, “Die Kirchezustände ...”, f. 234.

<sup>35</sup> M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens ...*, f. 77.

<sup>36</sup> Injac Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shek. XVII*, vëll. I (1610-1634), Tiranë: 1963, f.88: “Haverà da 80 case quasi tutte habitate da Christiani latini con puochi Turchi....Gl’habitanti non parlano altra lingua ch’l’Albanese e la turca”.

<sup>37</sup> M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens...*, f. 77 (përkth. shqip).

<sup>38</sup> Brocardus, “Directorium ad passagium faciendum...”, f. 483.

e Tivarit ishte e banuar atë kohë vetëm nga shqiptarë, njëlloj si Gucia, Plava, Shpuza e Podgorica që për këtë arsye u vendos t'i mohoheshin Malit të Zi që i pretendonte si të tijat<sup>39</sup>.

Në malësitë, shqiptarët jetonin më vete, ose të përzier me elementin sllav.<sup>40</sup> Studjues të ndryshëm, si B. Djurdjev e G. Stanojević, dallojnë aty fise malësore (*brdskij*) shqiptare dhe malazeze<sup>41</sup>. Megjithatë, nuk mund të shpëtojë pa u vënë re që dokumentet veneciane flasin ndonjëherë për “*li popoli Albanesi a Barda*”<sup>42</sup>, ku “Barda” qëndron për vendin e fiseve “brdskij”, gjegjësisht malazeze. Në fakt, malet e Bërdës (*monti di Barda*), ku përfshihej edhe fisi i Kuçëve e “*altri popoli*”, në të njëjtin kontekst gjeografik e kronologjik, quhen shpesh edhe malet e Shqipërisë (*monti d’Albania*)<sup>43</sup>. Gjithësesi, prania në Bërdë e “popujve”, d.m.th. fiseve shqiptare, flet për intensitetin e vendbanimeve shqiptare deri në malësitë lindore të Malit të Zi. Në fakt, shqiptarët i gjejmë me siguri tek fiset e Krainëve<sup>44</sup>, Hotëve<sup>45</sup>, Gjurashëve, që më vonë u quajtën Cërnojeviqë<sup>46</sup>,

<sup>39</sup> Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit*, vëll. I (1867-1912), Tiranë: 1984, f. 159.

<sup>40</sup> Selami Pulaha, *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, I, Tiranë: 1974, f. 33-34.

<sup>41</sup> Branislav Djurdjev, “Depedögen-Podgorica”, në: *Istorijski Zapisi*, viti XV, vëll. I, Titograd, 1962, f. 58-62; Gligor Stanojević, “Pokret brdskih i albanskih plemena yoci kandiskog rata”, në: *Istoriski Zapisi*, viti XIII, vëll. 3, Titograd: 1960, f. 513-522.

<sup>42</sup> G. Stanojević, “Pokret brdskih i albanskih plemena...”, f. 520-521.

<sup>43</sup> Kështu në dokumente venedikase të viteve 1687, 1688, 1689, shih: F. Ongania, *Il Montenegro da relazioni dei Provveditori veneti (1687-1735)*, Roma: 1896, f. 13, 26, 53.

<sup>44</sup> “А отъ Кранискнхъ Арваиасъ Плачке”, privilegj i mbretit Urosh III të Serbisë për manastirin e Shën Nikollës në ishullin e Vranjinës, rreth vitit 1322, në: AD I 679. Shih dhe: N. Jorga, *Notes et extraits...*, II, 478 (*Craynensi in Albania*). Defteri i vitit 1485 i sanxhakut të Shkodrës, pasqyron për Krajën një antroponimi të përzier, shqiptare e sllave. Shih: S. Pulaha, *Defteri i Sanxhakut Shkodrës 1485*, f. 143-145.

<sup>45</sup> N. Jorga, *Notes et extraits...*, vëll. I, f. 224, 250, 254; M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi*, f. 61 (v. 1434: *Junch Hoth iam dominus in partibus Albanie*).

<sup>46</sup> Në vitin 1410, kreu i këtij fisi, Gjergj Jura, dhe vëllai i tij, Aleks, quhen “shqiptar”(N. Jorga, *Notes et extraits*, I, 181). Në 18 tetor 1403 flitet për “*possendi tractare cum Jurassevich et aliis Albanensibus*” (AD II 741, shënimi). Në një dokument sllav të asaj kohe (1404), këta quhen: “Đurđe i Lêš Đurašević” (AD II 788 (shënimi 3). Që Gjurashët ishin Cërnojeviqë, këtë e pohon një dokument i po

Shestanëve<sup>47</sup>, Tuzëve<sup>48</sup>, Bitidosëve<sup>49</sup>, Matagushëve<sup>50</sup>, Dajçëve<sup>51</sup>, apo tek Piprët<sup>52</sup>, Bratnozhiqët, Palabardhët që më vonë e ndryshuan emrin në Bjelopavliqë<sup>53</sup>, Kelmendët<sup>54</sup> e Kuçët<sup>55</sup>. Në raportin e tij mbi Shqipërinë e

---

asaj kohe: “*Zernovichi chiamadi Giurazy*” (S. Ljubić, *Listine o odnošajih južnoga mletačke republike*, Zagreb, 1868-1891, vëll. IX, 303). Në vitet 1421-1430, dokumentet e Venedikut e të Raguzës bëjnë fjalë për “*domino Goicino Crnoievich*”, për të cilin thonë se ishte “*domino in Albania*” dhe se ishte shqiptar (*Goyzino Albanensi*). Shih: N. Jorga, *Notes et extraits...*, I, 532; II, 191, 232; L. Thalloczy-C. Jireček, “Zwei Urkunden aus Nordalbanien”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*, München und Leipzig: 1916, f. 141. Në 1 janar 1428, Senati i Venedikut refuzoi t’u japë shtetësinë veneciane vëllezërve Gjergj e Aleks Gjuraši, “*nobilium Zente, partium Albanie*”, pasi këta ishin përfshirë si shtetas serbë në Traktatin e vitit 1426 të Venedikut me despotin Gjergj Brankoviq (S. Ljubić, *Listine...*, IX, 10; N. Jorga, *Notes et extraits*, I, 465).

<sup>47</sup> N. Jorga, *Notes et extraits...*, I, 212-213; M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vëll. II, Città del Vaticano, 1992, nr. 325, f. 5. Defteri osman i vitit 1485 i Sanxhakut të Shkodrës, për nahijen e maleve të Shestanit ofron një antroponimi thujse tërësisht shqiptare, me emra si Gjon, Ded, Gjini, Maro, Nik, Mark, Pjetër, Pal), shih: S. Pulaha, *Defteri i sanxhakut të Shkodrës 1485*, f. 138, 139.

<sup>48</sup> N. Jorga, *Notes et extraits...*, I, f. 228-229. Defteri i Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, paraqet një antroponimi thelbësisht shqiptare të banorëve të tij (Lek, Gjon, Kol, Nik, Ded, Bardhosh, Pal, Llesh, Marin, Pjetër, Progon, Jak, Tanush, Kalush). Shih: S. Pulaha, *Defteri Sanxhakut Shkodrës 1485*, f. 152-154, 397.

<sup>49</sup> *Po aty*; M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi...*, f. 60.

<sup>50</sup> N. Jorga, *Notes et extraits...*, I, f. 285.

<sup>51</sup> *Po aty*.

<sup>52</sup> Tek Piprët, në vitin 1485, gjenden të ndërthurur tre elementë: shqiptarë, sllavë e vllahë. Shih: S. Pulaha, *Defteri Shkodrës 1485...*, f. 38.

<sup>53</sup> Thimi Mitko, *Bleta Shqiptare*, Vjenë: 1924, f. 210.

<sup>54</sup> R. L. Veselinović, “Die “Albaner” und “Klimenten” in den österreichischen Quellen zu Ende des 17. Jahrhunderts. Historisch-geographische und ethnographische Abhandlung”, në: *Mitteilungen des Österreichischen Staatsarchivs*, 13, Band, Wien: 1960, f. 195-230.

<sup>55</sup> Relacion i Marin Bolicës, viti 1614: “*Del rito romano, n. 490 Chuzzi Albanesi*”(I. Zamputi, *Relacione*, I, f. 272). Në Defterin e Sanxhakut të Shkodrës 1485, përmendet një fshat i madh me emrin Kuç, banorët e të cilit mbajnë në shumicë emra qartësisht shqiptarë, si Gjon, Kol, Pal, Gjergj, Gjini, Dedë, Lek, Marin, Nikollë etj. Shih: S. Pulaha, *Defteri sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485...*, f. 386. Viti 1652: “*Ma favellando delle quattro popolazioni de Piperi, Brattonisi, Bielopaulouicchi e Cuechi, liquali et il loro gran ualore nell’armi danno segno di*

shqiptarët e trevave veriore të përfshira atë kohë në operacionet e ushtrisë austriake kundër osmanëve, dërguar në 1 prill 1690 Perandorit austro-hungarez Leopoldi I, konti L. F. Marsigli thotë se shqiptarët në fjalë, të ndarë në 6-7 fise, ishin të ritit ortodoks, me përjashtim të Kelmendëve që ishin katolikë (“*gli Albanesi sono divisi in sei o sette distretti tutti di rito scismatico, eccetto li Climenti, che professano correttamente la fede cattolica romana*”)<sup>56</sup>. Në fakt, fqinj të fisit katolik shqiptar të Kelmendëve ishin, sipas pohimeve të ipeshkvit Marian Bolica në 1614, fiset Rovci (Rapshi?), Bjelopavliqi (Palabardhi), Pipëri, Bratonozhiqët e Vasojeviqët, që sipas tij ishin të krishterë ortodoksë. Për të treguar besimin e tyre, Bolica përdor konceptet “serbianë ose grekë” (*serviani o greci*), të cilat këtu duket qartë që nuk kanë një përmbajtje etnike: besimi ortodoks në këtë zonë përzierjesh etnike ishte karakteristikë e etnisë serbe, ndaj përcaktohet nga Bolica si “serbian”. Gjithsesi, për të mos lenë shkas për keqkuptime, ai i bashkëngjiti cilësorit “serbian” edhe cilësorin tjetër “grek”, me të cilin në literaturën e kohës kuptohej kisha dhe besimi ortodoks në viset e perandorisë së dikurshme “greke”, d.m.th. bizantine. Anasjelltas, e njëjta gjë ndodhte me besimin katolik, i cili në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi ishte karakteristikë e shqiptarëve, ndaj edhe sllavët e quanin atë thjesht “feja e shqiptarëve” (*arbanaska vjera*)<sup>57</sup>. Por ndryshe nga Marsigli, Bolica shënon jo vetëm një fis katolik, atë të Kelmendëve, por gjashtë të tillë<sup>58</sup>. Raporti mes sllavëve e shqiptarëve ka ndryshuar në mënyrë dinamike në rrjedhë të shekujve. Që në shek. XIV shquhen

---

*esser de sangue Albanese e a tale dalli Albanesi sono tenuti*”, shih: T. Lewicki, “Un manuscrit inconnu du XVII<sup>e</sup> siècle concernant l’Albanie et l’histoire des missions franciscaines dans ce pays”, extrait de la *Revue des Études Islamiques*, année 1948, Paris (Librairie orientaliste Paul Geuthner): 1949, f. 57. Një dokument i vitit 1699 dallon midis “Kuçëve të vegjël” katolikë, dhe “Kuçëve të mëdhenj”, ortodoksë, të cilët jetonin në një “konfederatë” të përbashkët: “*diro de Cucci piccoli overo la popolazione detta Triepsci quali sono soggetti alla citta di Podgorizza citta de Turchi. Questi Triepsci sono da 60 case in circa. Per quanto ho inteso sono cattolici quantunque vi siano poche case de Turchi et sono confederati con li Cucci grandi scismatici*”, shih: M. Jačov, *Le missioni cattoliche...*, vëll. II, f. 712.

<sup>56</sup> R. L. Veselinović, “Die “Albaner” und “Klimenten...”, f. 202.

<sup>57</sup> S. Ljubić, “Marijana Bolice Kotoranima opis skadarskoga sandžakata od godine 1614”, në: *Starine JAZU*, XII, Zagreb: 1880, f. 178, 181-182; P. Bogdani, *Cuneus Prophetarum*, Patavii: 1685 (Hyrje).

<sup>58</sup> S. Ljubić, “Marijana Bolice...”, f. 178, 181-182.

shenjat e një procesi që do të çonte në zbehjen e dallimeve etno-kulturore e deri në asimilimin e grupeve të tëra të popullsisë, proces që përparoi mjaft në kohën e sundimit osman<sup>59</sup>. Në mënyrë domethënëse, një tekst françeskan i shek. XVII, pasi pohon se fiset e Piperve, Bratonishëve, Bjelopavliqëve e Kuçëve ishin shqiptare, shton se: “*megjithatë, duke qenë se thujse që të gjithë ata ndjekin ritin serbian (ortodoks) dhe përdorin gjuhën ilirike (sllave), shumë shpejt do mund të quhen më shumë Sllavë, se sa Shqiptarë*”<sup>60</sup>. Për një kalim të besimtarëve katolikë në besimin ortodoks duket se flet edhe fakti që aty nga viti 1637, në kishën e vjetër të Shën Teklës në Spicë të Tivarit, njëri nga dy altarët ishte përshtatur për shërbimet fetare të ritit ortodoks<sup>61</sup>.

Tek ambiguiteti fetar e etnik i kësaj kohe, duhet ta ketë bazën edhe legjenda e origjinës së përbashkët të fiseve të Malit të Zi<sup>62</sup>.

Fryt i prirjeve të hershme shtetformuese në këtë pjesë të Ballkanit perëndimor, ishte krijimi i principatës së Dioklesë, të dëshmuar që nga shek. X. Pasi arriti të shkëputej nga Perandoria e Bizantit, kjo principatë arriti të krijojë identitetin e vet gjithnjë e më të pavarur në marrëdhëniet sa me strategët e Durrësit bizantin, aq edhe me Mbretërit bullgarë, me zhupanët e Rashës apo me prijësit e Trivunëve e Zaklumëve apo edhe me pushtetin normano-bizantin të Puljes. Në momente të veçanta, siç ishin ato të sundimit të Stefan Vojsllavit e të Konstantin Bodinit, Dioklea arriti të zhvillojë edhe një politikë ekspansioni në të gjitha drejtimet, veçanërisht në drejtim të temës bizantine të Durrësit. Kronika e Priftit të Dioklesë thotë se aty nga mesi i shek. XI, djemtë e Stefan Vojsllavit

<sup>59</sup> Defteri i Sanxhakut të Shkodrës (1485), ilustron mjaft mirë fenomenin e konvertimit nga besimi katolik në atë ortodoks, shoqëruar edhe me ndryshimin e emrave në trevat e Pejës, Zhabjakut, Krajës etj. Shih: S. Pulaha, *Defteri sanxhakut Shkodrës 1485*, f. 41; Titos Jochalas, *Testi greco-albanesi editi ed inediti*. Centro Internazionale di Studi Albanesi. Estratto dell'Annuario 1966-1967 del Centro Internazionale Studi Albanesi, Palermo: 1967, f. 11.

<sup>60</sup> “*nulla di meno essegno quasi tutti del rito seruiano, e di lingua Illirica, ponno più presto dirsi Schiavoni, ch'Albanesi*”, shih: T. Lewicki, “Un manuscrit inconnu du XVII<sup>e</sup> siècle...”, f. 57.

<sup>61</sup> I. Zamputi, *Relacione...*, II, f. 94.

<sup>62</sup> M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi...*, f. 59; A. Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia*, vëll. II, f. 218.

arritën të pushtojnë “gjithë tokën e Durrsakëve deri në lumin Vjosë”.<sup>63</sup> Ndërkaq, në kohën e Kostantin Bodinit, rreth vitit 1085, ky e bashkoi përsëri “tokën e Durrsakëve”, përfshirë edhe qytetin e Durrësit, me principatën e tij të Dioklesë<sup>64</sup>, gjë që do të thoshte aneksim i gjithë territorit të temës së rëndësishme bizantine me të njëjtin emër. Nga ana tjetër, diokleasit e shtrinë pushtetin e tyre edhe në Tribunie e Zaklumie, në veri<sup>65</sup>. Por në këtë krah, ata u ndodhën shpesh herë edhe nën presion e nën varësi të fiseve sllave të atyre vendeve. Shprehje e këtij raporti forcash mund të konsiderohet edhe fakti që aty nga mesi i shek. XI, sipas Kekaumenos, princ i Dioklesë ishte “trivunasi serb”, Stefan Voislavi” (ὁποῖον ἐποίησεν ὁ Τριβούνιος ὁ Σέρβος)<sup>66</sup>. Nga ana e tij, Skylitze e thërret Stefan Vojsllavin “arkond i Serbëve”(ὁ τῶν Σέρβων ἄρχων), ashtu siç thërret edhe trashëgimtarin e këtij, Mihalini, “kreu i Tribalëve dhe i Serbëve” (Τριβαλλῶν καὶ Σέρβων... ἀρχηγός)<sup>67</sup>. Këtu mbështeten, pa një pa dy, studiues të ndryshëm, posaçërisht ata serbë, që duke mbivlerësuar fragmente të tilla nga veprat e historianëve e kronistëve bizantinë, kanë dashur ta paraqesin Dioklenë si një “shtet serb”. Tani, që nga M. Rambaud, tek C. Jireček, G. Moravcsik e deri tek A. Toynbee, kanë paralajmëruar për pasaktësitë që përmbajnë veprat e autorëve bizantinë për sa i përket emërtimeve etno-gjeografike<sup>68</sup>. Për të sjellë një shembull domethënës, Konstantin Porfyrogenneti në shek. X quan “Iliri” atë krahinë të Kaukazit, që përndryshe në të gjitha kohërat është njohur me emrin “Albania”, dhe kjo padyshim është një lajthitje,

<sup>63</sup> F. Šišić, *Letopis Popa Dukljanina*, Srpska Akademija Nauka, Beograd-Zagreb: 1928, f. 353.

<sup>64</sup> “tulit atque obtinuit totam terram Duracinorum et ipsam civitatem Durachium”, shih: F. Šišić, *Letopis Popa Dukljanina*, f. 361.

<sup>65</sup> An. Komnena, *Alexias*, ed. L. Scopen, Bonnae: 1839, f. 141; F. Šišić, *Letopis Popa Dukljanina*, f. 353, 356.

<sup>66</sup> shih: Kekaumenos, *Strategicon*, ed. B. Wassiliewsky-V. Jernstedt, St. Petersburg, 1896, f. 25; Joannis Scylitzae, *Synopsis Historiarum*, rec. J. Thurn, Berlin-New York: 1973, f. 408.

<sup>67</sup> J. Scylitzae, *Synopsis Historiarum ...*, f. 408.

<sup>68</sup> M. Rambaud, *L'empire grec au dixième siècle*, Paris: 1870, f. 210; C. Jireček, *Geschichte der Serben*, (f. 148-151, sipas përkth. shqip); G. Moravcsik, *Byzantinoturcica*, I, f. 363; A. Toynbee, *Constantine Porphyrogenitus and his World*, London: 1973, f. 581.

edhe pse e ka një shpjegim<sup>69</sup>. Në fakt, ekzistonte një ekuacion etno-gjeografik Iliri-Albani nw Ballkanin bizantin, në Shqipërinë e sotme. Autorë të ndryshëm bizantinë të Mesjetës vazhdonin të përdornin në mesjetë emërtimet e lashtësisë “Iliri” dhe “Ilirë” për “Albaninë” dhe “Albanët” mesjetarë. Porfyrogenneti këtë ekuacion e transporton në mënyrë të papërshtatshme edhe në Kaukazin e largët, ku ekzistonte në fakt një vend i quajtur “Albania” me banorë të quajtur “Albanë”. Por kjo “Albani” nuk kishte sigurisht asnjë lidhje si me thënë gjenetike me “Ilirinë”, siç kishte lidhje me Ilirinë e antikitetit “Albania” mesjetare e Ballkanit<sup>70</sup>. Nuk do të donim të zgjateshim me citimin e shembujve për përdorimin e gabuar të emërimit “serb” për “sllav”, të emërimit “sllav” për “diokleas”, “shqiptar” për “sllav” apo “roman” për “shqiptar” në burimet mesjetare. Por, po kalojmë në një moment të rëndësishëm historik, siç është aneksimi i Dioklesë nga ana e Stefan Nemanjës, aty nga viti 1198.

Sigurisht, ky ishte kurorëzim i një presioni të gjatë që përplasej mbi Diokle nga ana e Rashës, në Lindje. S’ka dyshim, që në këtë rast kemi të bëjmë me një pushtim të vërtetë, dhe jo me një lloj “Anschluss-i” (bashkimi) paqësor të një shteti të vogël “serb”, me një shtet më të madh, po “serb”. Këtë e lë të kuptohet qartë vetë një burim i rëndësishëm serb i fillimit të shek. XIII, “Jeta e Stefan Nemanjës”. Sipas këtij burimi, mbreti i Rashës, me përjashtim të Kotorrit ku vendosi selinë e tij, të gjitha qytetet e tjera të Dioklesë, si Danjën, Sardën, Drishtin, Shkodrën me Rozafën, Shasin, Ulqinin dhe “qytetin e famshëm të Tivarit”, i bëri rrafsh me tokën “duke e kthyer shkëlqimin e lavdinë e tyre të dikurshme në një shkretim, në mënyrë që emri i tyre në këto anë të zhdukej një herë e mirë”<sup>71</sup>. Për sa i përket banorëve vendas, “Jeta e Nemanjës” na thotë se

<sup>69</sup> Const. Porphyrogenitus, *De administrando imperio*, bot. G. Moravcsik, Budapest: 1949, f. 212.

<sup>70</sup> Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*, Tiranë: “Pegi”, 2006, f. 8-9, ku edhe bibliografia përkatëse.

<sup>71</sup> S. Hafner, *Stefan Nemanja nach den Viten des hl.Sava und Stefans des Ersgekrönten*. Serbisches Mittelalter: Altserbische Herrscherbiographien, Graz-Wien-Köln (Styria Verlag): 1962, f. 88; Shih edhe: S. Cirković, *Istorija Crne Gore*, vëll. II, Titograd: 1970, f. 3. Për shkatërrimet që pësuan qytetet në fjalë nga serbët edhe në kohët e mëvonshme, në vitin 1356, thuhet për Drishtin: *ab ipsius regni scismaticis quasi totaliter dissipatum*. Shih: A. Theiner, *Monumenta Slavorum Meridionalium...*, I, nr. 320 e 355, fq. 236 e 259.

jeta e tyre “u kursye në mënyrë që këta t’i shërbenin me frikë pushtetit të tij (Nemanjës) e t’i paguanin atij taksa”<sup>72</sup>. Pra, serbët e Nemanjës u sollën në Diokle si me një vend e me një popull të huaj, armik, ku ata imponuan ligjin e pushtuesit. Të dhëna të mëvonshme, të shek. XIII-XIV e që i përkasin sidomos marrëdhënieve politike e fetare në Mal të Zi e në Shqipërinë e Veriut, flasin qartë për shpronësime të bujarëve vendas, pushtime kishash e dëbime klerikësh, ripagëzime me dhunë e ndërrime emrash, gjëra të cilat patën rolin e tyre edhe në proceset e asimilimit kulturor e etnik që u vunë re qysh në këtë periudhë<sup>73</sup>. Për një proces serbizimi nëpërmjet konvertimit fetar bëhet fjalë sa në Kodin e Stefan Dushanit e në ankesat e vazhdueshme të Papatit, aq edhe në Statutet e Budvës<sup>74</sup>, ndërkohë që shembulli i cituar më sipër i fiseve të Kuçëve, Piprëve, Bratnozhiqëve e Bjelopavliqëve në shek. XVII, shqiptarë në origjinë por tashmë ortodoksë në besim e sllavë në gjuhë, ofron një shembull të qartë të ecurisë praktike të këtij procesi<sup>75</sup>.

Bashkë me pozicionin gjeografik të lakmueshëm, pushtimi i Zetës i sollti Nemanicëve serbë edhe një problematikë delikate, duke qenë një vend kryesisht katolik, me lidhje të posaçme me Papatin dhe me Perëndimin. Ndaj, për një koniunkturë politike, mbretërit Nemanja u detyruan t’i njohin Malit të Zi një status të veçantë. Gjatë kohës së mbretërimit të Stefan Uroshit I (1252-1284), ky ia besoi qeverisjen e

<sup>72</sup> S. Hafner, *Stefan Nemanja nach den Viten...*, f. 88.

<sup>73</sup> Për to bëhet fjalë në një relacion anonim të vitit 1308, në relacionin e Brokardit (1331) apo edhe në ankesat e ndryshme të papëve të Romës drejtuar mbretërve Nemanja në shek. XIII-XIV apo edhe në vetë Kodin e Stefan Dushanit. Shih: O. Gôrka, *Anonymi descriptio Europae Orientalis*, Cracoviae, 1916, f. 31; Brocardus, “Directorium ad passagium faciendum”, vëll. II, f. 484-485; A. Theiner, *Monumenta Slavorum Meridionalium*, I, nr. 181 e 280, f. 129 e 215; A. Theiner, *Monumenta Hungarica*, I, f. 734-5; II, f. 8-17; *Lois et ordonnances du tzar Etienne*, në: Ami Bouè, *La Turquie d’Europe*, vëll. 4, Paris: 1840, f. 427; St. Novaković, *Zakonik Stefana Dušana*, Beograd: 1898, f. 153-154; C. Jireček, *Geschichte der Serben*, f. 407-408 (bot. shqip f. 449-450); P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit...*, f. 273-282. Mbi dukurinë e ripagëzimit të katolikëve në Perandorinë Bizantine në shek. XIV-XV, shih: T. Kolbaba, “On the closing of the Churches and the rebaptism of Latins”, në: *Byzantine and Modern Greek Studies*, nr. 29/1 (2005), f. 48.

<sup>74</sup> “...se il figliolo diventasse heretico o scismatico della fede romana”, shih: “Statuto di Budua”, në: S. Novaković, *Zakonski spomenici*, f. 64.

<sup>75</sup> M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi...*, f. 77; T. Lewicki, “Un manuscrit inconnu du XVII<sup>e</sup> siècle...”, f. 57.

Zetës gruas së tij, francezes katolike Helenë. Në kohën e saj, Zeta mori dukjen e një nën-mbretërie (*vice-regnum*) me autonomi të dukshme në raport me Rashën. Helena ndërtoi marrëdhënie të veçanta me popullsitë vendase, ku la përgjithësisht një kujtim të mirë, por edhe me shtetet e tjera, duke u diferencuar dukshëm nga tradita e Nemanjiçëve serbë. Këtë e provojnë, siç thamë, marrëdhëniet e ngrohta që ajo pati me komunitetin shqiptar katolik të Zetës, apo me Republikën e Raguzës, ndërkohë që burri i saj, mbreti Uroshi I i Serbisë, ishte në marrëdhënie konfliktuale me ta<sup>76</sup>. Janë të dëshmuara lidhjet e drejtpërdrejta të Helenës me papën e Romës, me mbretin e Napolit, me Republikën e Raguzës, me mbretin e Bullgarisë<sup>77</sup>. Në mbretërinë mesjetare serbe të Nemanjëve, që u kthye në një vend persekutimi për besimtarët katolikë, kjo princeshë katolike u mundua ta kthejë Zetën në një kënd të mbrojtur të katolicizmit, dhe akoma më shumë, në një bazë për shtrirjen e katolicizmit në thellësi të Ballkanit ortodoks. Në fakt, nga një letër e papës Nikolla IV e 20 marsit 1291, mësohet se zonja e Zetës kishte marrë angazhim të kthente në fenë katolike mbretin e Bullgarisë<sup>78</sup>. Jo rastësisht, papa Nikolla gjente rastin të mburte zellin e zonjës Helenë, e cila jo vetëm që “kishte ruajtur ajo vetë me dashuri e përkushtim fenë katolike, por nuk kishte pushuar t’ua mësonte atë edhe të tjerëve, duke i shtrirë tej e më tej kufijtë e saj”<sup>79</sup>. Në fakt, Kisha e Romës, ndërsa politikisht e trajtonte mbretëreshën Helenë në një plan me Perandorin e Bizantit e me mbretin e Serbisë<sup>80</sup>, në planin fetar e konsideronte atë si dorën e zgjatur të kishës katolike në hemisferin ortodoks të Ballkanit. Jo pa arsye, në 17 nëntor 1303, papa Benedikti XI shpallte se e vendoste Helenën dhe zotërimet e saj, nën mbrojtjen e tij e

<sup>76</sup> Kështu, në 1268 Helena u premtoi të dërguarve të Raguzës, se ajo do ta mbronte qytetin e tyre dhe do të ishte me të edhe në rast se mbreti serb, burri i saj, do të nisej me ushtri kundër Raguzës. Shih: C. Jireček, *Geschichte der Serben*, (përk. shqip), f. 363.

<sup>77</sup> AD I, f. 514, 520, 544, 559; D. Farlatus, *Illyricum Sacrum*, vëll. VII, Venetiis: 1817, f. 52-53.

<sup>78</sup> “*ut magnifico Principi Georgio Imperatori Bulgarorum Illustri, cum quo super reductione ipsius ad devotionem sacrosanctae Romanae Ecclesiae, ac ad Fidei catholicae unionis proponis habere colloquium hac aestate*”, D. Farlatus, *Illyricum Sacrum*, VII, f. 53.

<sup>79</sup> D. Farlatus, *Illyricum Sacrum*, f. 52.

<sup>80</sup> Kështu, në 18 nëntor 1303, papa Benedikti XI i beson Helenës të njëjtën përgjegjësi për mbrojtjen e klerit katolik në trevat e Ballkanit, si edhe perandorit bizantin Andronik II dhe mbretit serb Urosh II (AD I 554).

të Kishës katolike<sup>81</sup>. Gjithsesi, nuk duhet harruar që duke u martuar me Helenën katolike dhe duke i deleguar kësaj për gati 40 vjet kujdestarinë mbi Zetën, mbreti Stefan I Urosh bënte një lëvizje të zgjuar, nga njera anë për të tërhequr popullsitë vendase e katolike, kurse nga ana tjetër për të amortizuar aty përplasjet me Papatin e perëndimin katolik. Nuk është një rastësi, që pikërisht pas zhdukjes nga skena të Uroshit I e të Helenës (1314), Zeta u kthye në një teatër konfliktesh të ashpra politike, etnike, ushtarake e fetare<sup>82</sup> dhe në një objektiv të kryqëzatave të Perëndimit katolik<sup>83</sup>.

Pas më se 150 vjet nën sundimin e Nemanjiçëve serbë, në gjysmën e dytë të shek. XIV Zeta iu rikthye traditës shtetërore të shtetit të dikurshëm të Dioklesë. Bartësja e pavarësisë së rilindur të saj ishte dinastia Balsha. Vendosja e sundimit të Balshajve në Zetë u realizua si një akt ndarjeje dhe armiqësie me trashëgimtarët e Stefan Dushanit, aty nga viti 1368. Pikërisht atë vit, cari serb Stefan Urosh e quante si “rebel të tij” Gjergjin I Balsha<sup>84</sup>. Po atë vit, vëllezërit Balsha, pranoheshin si qytetarë të Raguzës, dhe një vit më vonë, edhe si qytetarë të Venedikut<sup>85</sup>. Me këtë hap shënohej një prirje e re marrëdhëniesh e aleancash, e

<sup>81</sup> “*personam tuam et regnum predictum cum civitatibus, castris, terris, villis et bonis aliis...sub beati Petri et nostra protectione suscipimus*”. Të njëjtën gjë e përsërit edhe papa Klementi V në nëntor 1307. Shih: A. Theiner, *Vetera Monumenta historica Hungariam sacram illustrantia*, t. I (1216-1352), Romae: 1859, nr. 648, 661.

<sup>82</sup> Nën Stefan II Urosh (1296-1321) dhe Stefan Dushanin (1331-1355) shtohen zërat mbi persekutimet ndaj katolikëve, mbi pushtimin e kishave katolike dhe kthimin e tyre në kisha ortodokse, mbi konvertimin e ripagëzimin me dhune të popullsisë katolike të Zetës e të Kosovës. Shih: A. Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia*, t. I: 1198-1548, Romae: 1863, nr. 179, 280, 320; A. Theiner, *Vetera Monumenta Historica Hungariam Sacram Illustrantia*, t. I (1216-1352), Romae: 1859, nr. 1264; t. II, nr. 16; A. Boué, “Lois et ordonnances du tzar Etienne”, në: *La Turquie d'Europe*, vëll. IV, Paris: 1840, f. 427; St. Novaković, *Zakonik Stefana Dušana*, Beograd: 1898, f. 153-154; P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit...*, f. 267-282.

<sup>83</sup> A. Theiner, *Vetera Monumenta Historica Hungariam ...*, vëll. I (1216-1352), nr. 1264, f 831; AD I 648, 649 e 650.

<sup>84</sup> Constantin Jireček, “Srpski car Uroš, kral Vukašin i Dubrovčani”, në: *Zbornik Konstantina Jirečeka*. Srpska Akademija Nauka. Knj. II, Beograd: 1959, f. 371.

<sup>85</sup> AD II 159. Shih: AD II 161 (shënim).

ndryshme nga ato që kishin karakterizuar sundimin e Nemanjiçëve serbë. Prirje, që u kurorëzua shumë shpejt, në 29 janar 1369, me rikthimin e Balshajve në fenë katolike<sup>86</sup>.

Balshajt ishin produkt tipik i tokës së tyre, madje edhe në kuptimin e ngushtë karakterial. Dokumentat e kohës e përshkruajnë ndonjërin prej tyre si “inatçor e pa arsye” (*uomo furioso che non possiede rason*)<sup>87</sup>. Raguzanët vinin në dukje “zakonet shqiptare” (*costumi albanesi*) të Balshajve<sup>88</sup>. Ndër zakone të tilla mund të përfshihet hakmarrja e egër ndaj kundërshtarëve të tyre, qoftë edhe kur këta ishin klerikë, apo rënia në gjak me krerë kundërshtarë fisesh, siç ishte rasti i rënies në gjak me fisin e Hotëve (*quia manus posuit in sanguine eorum*)<sup>89</sup>. Një “zakoni të vjetër kombëtar” ia atribuon Gelcich edhe mënyrën si përthyhej tek Balshajt institucioni i bashkëqeverisjes (korregjencës)<sup>90</sup>. Këtë e ndeshim sigurisht në Bizant e në Serbinë mesjetare<sup>91</sup>. Por, ndërsa këtu bashkë-

<sup>86</sup> A. Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium*, I, nr. 362.

<sup>87</sup> G. Gelcich, *Zeta...*, f. 106. Shih edhe: N. Jorga, *Notes et extraits*, I, 290: për Balshën III, 1419: *exosus suismet*.

<sup>88</sup> J. Tadić, *Pisma i uputstva Dubrovačke Republike*, Beograd: 1935, cituar sipas: S. Čirković, *Les Albanais dans les sources des Slaves du Sud*, f. 356.

<sup>89</sup> N. Jorga, *Notes et extraits pour servir à l'histoire des Croisades au XV<sup>e</sup> siècle*, vëll. I, Paris: 1896, f. 254; G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balscidi*, Spalato, 1899 (bot. shqip. 2009), f. 332-333. “Në gjak” ishte Balsha III, në 1413, edhe me Shestanët e malësisë së Tivarit: në fakt, ai kishte urdhëruar t’u pritej një këmbë e një dorë dy vëllezërve Shestanë, pasi këta u lidhën me Venedikun (N. Jorga, *Notes et extraits*, I, 212-213), shenjë kjo, që edhe marrëdhëniet “politike” në këtë mjedis ishin prekur nga rregulli i gjakmarrjes, siç e konfirmon në 1332 edhe Guljelmi i Adës, i cili i sheh nën prizmin e “gjakut” edhe marrëdhëniet e shqiptarëve me pushtuesit e tyre serbë: “*ipsi omnes et ipsorum singuli in predictorum Sclavorum sanguine manus suas crederent consecrare*”, shih: *Recueil des historiens des Croisades*. Documents Armeniens. Tome II, Paris: 1906, f. 484.

Në vitin 1412, ipeshkvi Françesk i Drishtit persekutohej nga Balsha III si përkrahës i Venedikut. Vartësi i tij, abati Andrea Sporo i Shën Gjonit e pësoi shumë më keq, pasi u fut në burg dhe u mbajt “*in compedibus ferreis*”, nga sundimtari shqiptar. Gjithashtu mësohet se në 1414, princi Balsha III duhej të ruhej si çdo i krishter i zakonshëm, nga hakmarrja e fisit të Hotëve, me të cilët “kishte rënë në gjak” (*quia manus posuit in sanguine eorum*)<sup>89</sup>. Shih: N. Jorga, *Notes et extraits*, I, 310.

<sup>90</sup> G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balscidi...*, f. 31 (bot. shqip. f. 33).

<sup>91</sup> F. Dölger, “Das byzantinische Mitkaisertum in den Urkunden”, në: *Byzantinische Diplomatie*, Speyer am Rhein: 1956, f. 102 e vijim; M. Mladenovich,

qeverisja (korregjenca) realizohej në vijë birërore, d.m.th. nëpërmjet kooptimit në drejtimin e shtetit të djalit të madh të sovranit, i cili bëhej edhe trashëgimtar i fronit pas vdekjes së të atit, tek Balshajt shohim që bashkëqeverisja realizohej në vijë vëllazërore, d.m.th. ishin vëllezërit, të gjithë, ata që qeverisnin e që ndanin mes tyre e në të njëjtën masë territorin dhe sovranitetin e shtetit. Sigurisht, vëllai i madh kishte mbi vëllezërit një autoritet moral epror. Në aktin e konvertimit të tre vëllezërve Balsha, në 1369, Strazimiri deklaronte se në cilësinë e vëllait të madh, ai po vendoste në fund të aktit një vulë të përbashkët të të tre vëllezërve, “pasi ai vetë nuk kishte vulë të veçantë”<sup>92</sup>. Asnjë veprim apo akt zyrtar që kishte të bënte me shtetin nuk mund të ndërmerrej në mënyrë të njëanshme nga njëri prej vëllezërve bashkësundimtarë (konregjentë). Në rast se brezi i vëllezërve sundimtarë shuhej deri tek i fundit, ishin djemtë e vëllait më të madh ata që trashëgonin pushtetin. Pra, trashëgimi i pushtetit nga një brezni vëllezërish në brezninë tjetër të bijve të tyre, realizohej nëpërmjet zbatimit të institucionit të *primogeniturës*, ku djemtë e vëllait të madh ishin ata që trashëgonin pushtetin. Kalimin nga njëra brezni në tjetrën, e garantonte përfshirja në “protokollin” zyrtar e djalit të parë të vëllait të madh bashkësundimtar që në kohën kur i ati dhe xhaxhallarët e tij drejtonin shtetin<sup>93</sup>. Raguzanët e njihnin mirë këtë praktikë të Balshajve, ndaj bënë kujdes që të porosisnin ambasadorët e tyre që të takonin e të negocionin njëherësh me të tre vëllezërit Balsha, pasi vendimmarrja u përkiste të treve njësoj<sup>94</sup>. Këtë praktikë qeverisëse specifike, e gjejmë edhe tek të tjera familje princore shqiptare, tek Shpatajt e Epirit, Muzakajt e Beratit apo Dukagjinët e Lezhës<sup>95</sup>.

---

*L'état serbe au Moyen âge*, Paris: 1931; Constantin Jireček, *La civilisation serbe au Moyen âge*, Paris: 1920, f. 3-5.

<sup>92</sup> “*et sigillum commune nostrorum trium fratrum, cum proprium non habeam, apponi feci*”, shih: A. Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium*, I, nr. 362; AD II 253.

<sup>93</sup> Kështu, kur Balshajt hynë në Prizren, në 1372, atyre iu dhuruan katër parzmorë: veç tre vëllezërve, përfitoi një të tillë edhe djali i madh i vëllait të madh të tre bashkësundimtarëve, Gjergji II Strazimiri.

<sup>94</sup> Viti 1363: “*debeat facere ambaxiatam omnibus tribus fratribus de Balsa simul*”, AD II 184.

<sup>95</sup> Po atë kohë, vëllezërit Gjini e Zguro Shpata sundonin në Despotatin e Artës dhe tre vëllezër Muzaka, Gjini, Teodori dhe Stoja, sundonin në Despotatin e Beratit. E njëjta gjë vlen të thuhet edhe për Dukagjinët (në 1394, Senati porositi

Në fakt, jo vetëm për këto norma e praktika tradicionale Balshajt duhet t'i përkisnin një familjeje shqiptare. Sipas Grigor Zamblakut e Konstantin Filozofit, Gjergj Strazimir Balsha e Balsha III ishin zotër shqiptarë (арбанашьскыи господинь)<sup>96</sup>. Megjithatë, përsa i përket ideologjisë dhe modelit të shtetit që ata donin të ndërtonin, tek ta gjejmë të përziera ndikime serbe, bizantine e veneciane. Si tek të gjithë zotërit e mesjetës, edhe tek Balshajt modeli i shtetit që ata donin të imitonin nxjerr kokë në vetë titullaturat zyrtare me të cilat ata prezantohen në dokumente të kohës<sup>97</sup>. Disa prej Balshajve, si Balsha II e Konstantin Balsha, u quajtën me titullin “mbret”<sup>98</sup>. Në tetor 1377, kur sundimtari i Bosnjës,

---

bajliun e vet të “kërkojë fjalën e njërit prej vëllezërve Dukagjinë, pasi tjetri kishte vdekur”: *de consensu unius Duchayni, quia alter mortuus est*) dhe për Gjurash-Crnojeviqët. Shih: L. Vranussi, *To chronikon ton Joanninon*, Athinë, 1965, paragr. 16; G. Schirò, *Cronaca dei Tocco di Cefalonia*, Roma, 1975, f. 234; AD II 184, 242, 520; N. Jorga, *Notes et extraits*, III, 89.

<sup>96</sup> “въ тоже врѣме прииде и нетии него Бальша арбанашьскыи господинь”, kështu në Jetëshkrimin e Stefan Lazareviçit, botuar në: *Glasnik Srpskog Učenog Društva*, knj. 41, Beograd: 1875, f. 313 (citur sipas: S. Ćirković, *Les Albanais dans les sources des Slaves du Sud*, f. 356). Shih gjithashtu, viti 1392: “Çasse bastardo Jure de Balsa” i cili në një dokument të vitit 1398 cilësohet: “Zasso Albanensi”, në: AD II 477, shih dhe shënimet. Balshajt konsideroheshin shqiptarë nga C. du Cange, *Historia Byzantina*, vëll. I: *Familiae Augustae Byzantinae, Venetiis: 1729*, f. 266: *quidam ex Albaniae proceribus cognomento Balsa*. Weigand gjithashtu i quan shqiptarë, duke e shpjeguar emrin “Balshë” të prejardhur nga “ball”, shih: G. Weigand, “Albanische Einwanderungen in Siebenburgen”, në: *Balkan-Archiv*, III. Band, Leipzig: 1927, f. 224. Po ashtu: S. Ćirković, “Les Albanais dans les sources historiques des Slaves du Sud”, në: *Les Illyriens et les Albanais*, Beograd: 1988, f. 356. Balshajt ishin shqiptarë edhe për I. Božić, “Neverstvo Vuka Brankovića”, në: I. Božić-B. Djurić (përg.), *O Knjezu Lazaru, naučni skup*, Kruševac: 1971. Filozofski Fakultet, Odeljenje za istoriju umetnosti, Beograd: 1975, f. 235.

<sup>97</sup> B. Ferjaničić, “Vladarska ideologija u srpskoj diplomaciji posle propasti Carstva, 1371”, në: *O Knjezu Lazaru*, Beograd: 1975, f. 142.

<sup>98</sup> G. Musachi, “Genealogia”, në: Ch. Hopf, *Chroniques gréco-romanes inédites ou peu connues*, Berlin: 1873, f. 290. Konstantin Balsha, djalë i Gjergjit I Balsha dhe i Teodorës, ish grua e Zarko Merkshtës, nxorri monedhën e tij me titullin pompoz *Dominus Rex Costantinus*. Në vitin 1393, me sa duket i pafuqishëm ndaj presionit osman, Kostantini i kishte propozuar Venedikut të strehohej bashkë me familjen në zotërimet e tij, konkretisht në Negropont ose në Korfuz, pasi të kishte fortifikuar pesë ose gjashtë ndër kështjellat e tij. Përpara tij, në 1387, Karl Topia në

Trvtko, e shpalli veten “mbret i Serbisë, Bosnjës, vendeve bregdetare dhe i vendeve perëndimore”, i vetmi që reagoi armiqësisht ishte Gjergj Balsha, pavarësisht se nga uzurpimi prej Trvtkos i këtij titulli, që kishte qenë i mbretërve të Serbisë, ata që duhet të revoltoheshin të parët ishin epigonët serbë të Nemanjiçëve<sup>99</sup>. Gjergji I Balsha nuk dimë të ketë mbajtur një titull të tillë, por megjithatë, nën shembullin e mbretërve Nemanjiçë, ai u merrte raguzanëve “kontributin e Shën Dhimitrit” ose, siç quhej rëndom “kontributi serb”<sup>100</sup>. Gjithashtu, nën shembullin e “dukëve” bizantinë e venecianë të Durrësit, me marrjen e këtij qyteti, në 1384, Balsha II i shtoi titullit të mbretit, edhe atë të dukës së Durrësit (доука Драчкн)<sup>101</sup>. Në *Epitafin e Glavinicës* (1373), Gjergji e Balsha II cilësohen si “zotër të lartë të Serbisë, Romanisë e të gjithë Arbërit”<sup>102</sup>, pavarësisht se, në dallim nga mbretërit serbë, ata zotëronin atë kohë vetëm Zetën dhe një pjesë të Shqipërisë, deri në Vlorë e Berat.

Në fund, edhe pse krijuan një shtet me shtrirje të konsiderueshme në arealin shqiptaro-malazez, edhe pse me tituj e me sjellje prej sovrani, me lidhje të shumta me botën e jashtme, edhe pse shtypën monedhën e tyre,<sup>103</sup> Balshajt mbetën zotër tradicionalë lokalë, me një pushtet që arriti të ishte real dhe afektiv në viset shqiptare e veçanërisht në vendin e tyre të origjinës, në Zetë. Por edhe këtu, ndërsa mbanin seli në qytetet

---

pamundësi “*propter potentiam Turchorum de facili defendere et salvare civitatem Durachii cum fortificiis suis*”, i propozoi Republikës t’i dorëzonte Durrësin dhe të shpërblehej me ndonjë zotërim në Kandia (Kretë) ose në Negropont. Shih: AD II 409, 503; Ivan Bozić, “Neverstvo Vuka Brankoviča”, në: *O Knjezu Lazaru*, Beograd, 1975, f. 232, 235.

<sup>99</sup> Rade Mihaljčić, “Knez Lazar i obnova srpske države”, në: *O Knjezu Lazaru*, f. 6-7.

<sup>100</sup> Ivan Bozić, “Neverstvo Vuka Brankoviča”, në: I. Bozić-B. Djurić (përg.), *O Knjezu Lazaru*, naučni skup, Kruševac 1971. Filozofski Fakultet, Odeljenje za istoriju umetnosti, Beograd 1975, f. 235, shën. 34.

<sup>101</sup> AD II 388.

<sup>102</sup> “επη της αυθεντας του ηψηλοτατων αυθεντων Σερβιας και Ρομανιας και πασης Αλβανου και αυταδελφου Γεοργηου και Μπαλσα”, në: Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë: “Shkenca”, 1999, f. 84-85.

<sup>103</sup> “*denarii Balse*”, N. Jorga, *Notes et extraits*, II, 324; V. Celestin, “Eine Münze Georgs II. Strazimir, geprägt in der Stadt Scutari”, në: *Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und Herzegovina*, 6 (1899) f. 538-540.

kryesore dhe në Shkodër, *principale eorum domicilium*,<sup>104</sup> ata vazhdonin të qëndronin për periudha të gjata në malësitë nga vinin, strehë e sigurtë për t'u mbrojtur nga rreziqet.<sup>105</sup> Ishte një praktikë e zakonshme e ndjekur tradicionalisht nga princërit e vendit, siç ndodhi në fillim të shek. XI me princin Gjon Vladimir, i cili, kur bullgarët e car Samuelit sulmuan Dioklenë, u ngjit bashkë me njerëzit e tij në malin Oblik, ku bullgarët nuk mundën të ngjiteshin<sup>106</sup>.

### *S u m m a r y*

#### ALBANIAN-MONTENEGRIN COMMONALITIES DURING THE MIDDLE AGES

For a long time, there has been a lively debate about the identity, the culture, and the political and legal institutions of Montenegro (Dioclea, Zeta) in the Middle Ages. One theory, mainly supported by Serbian scholars, argues that Montenegro as well as the regions north and north-east of it, became ethnically Slav during the colonization of the sixth and seventh centuries and therefore, the history of this country and its people is a part of the Serbians' history. Other scholars, on the contrary, are firm in their argument that Montenegro during the Slavic settling, was not affected, at least not to a large extent and that this territory was ethnically, politically and culturally linked with the regions southwards, belonging to present day Albania. In fact, the Byzantine historian of the tenth century, Constantine Porphyrogenetus clearly states that in the south the Slavic colonization spread up to the bay of Kotor (Deukaterion), where the Byzantine Emperor Herakles allowed to settle people of the tribes of *Zakluma*, *Tërbuna* and *Kanalit*, Slavic tribes distinguished from Serbian ones that were settled in the interior of the country. The archeological discoveries and anthropological researches also show the historical continuity in the region of Dioclea. In addition, the Serbian chronicles starting from the thirteenth century onwards consider Dioclea and its population as foreign. One element that strongly testifies this is undoubtedly the acceptance of Catholicism in contrast to what happened in Serbia.

Meanwhile, the historical sources speak about a consistent Albanian population in Montenegro, even beyond the towns of Ulcinj, Antibari and

<sup>104</sup> A. Theiner, *Monumenta Slavorum Meridionalium*, t. I, nr. 262.

<sup>105</sup> N. Jorga, *Notes et extraits...*, I, f. 265.

<sup>106</sup> F. Šišić, *Ljetopis popa Dukljanina...*, f. 331; M. Šufflay, "Die Kirchenzustände ...", f. 192.

Budva. This is also true for the interior mountainous part of the territory where Kraja, Hoti, Gjurashi (Cernojevic), Shestani, Tuzi, Bitidosi, Matagushi, Pipri, Bratonishi, Palabardhi, Kuçi and Kelmendi tribes are defined as Albanian tribes of catholic religion. However, with the establishment of Serbian political and religious authority in these territories during the Nemanja dynasty (thirteenth and fourteenth centuries) and moreover during the ottoman rule, a great deal of these tribes converted to the orthodox religion and simultaneously started to use the Slavic language. This process of cultural assimilation which in many cases resulted in ethnic assimilation can be found in other peripheral Albanian tribes, too.

Lastly, we have argued that the Montenegrin regions (Dioclea, Zeta), politically speaking, have been for long periods of time part of the same state structure, be it under the Byzantine and Serbian rule or during the time of the Albanian independent principalities of fourteenth and fifteenth centuries when Zeta was the center of the Balsha Principality which in its best days extended from Budva to Kosovo and southwards to Southern Albania.

